

**VENDIM**  
**Nr. 682, datë 15.10.2014**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT**  
**RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas nenit 7, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

**Rregullimi i qarkullimit në qendrat e banuara**

(Neni 7 i Kodit Rrugor)

1. Në rrugët urbane të qendrave historike, qendrave “Ansambël kulturor”, “Ansambël historik”, “Ansambël muze”, “Zonë muze”, “Ansambël urban” dhe në rrugët me vlera të veçanta kulturore, Ministria e Kulturës, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Punëve të Brendshme përcaktojnë rregullat për kufizimin e qarkullimit të automjeteve, si dhe kufizimin e parkimeve në këto zona.

2. Në Ansamblin Monument Kulture të aksit kryesor dhe Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës ndalohet apo kufizohet qarkullimi i automjeteve të të gjitha ose të disa kategorive, ndalohet apo kufizohet parkimi i automjeteve në zonat e sheshit “Nënë Tereza” dhe bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, sipas përcaktimeve të parashikuara me urdhër të përbashkët të ministrit të Kulturës, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**